



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 131, datë 24.07.2019

**PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË ZJ. ELSA TOÇI
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SI AKTUAR I AUTORIZUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 222/5, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Rregullores nr. 37, datë 27.03.2019 “Mbi rinovimin e licencës së Aktuarit të Autorizuar”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Rinovimin e licencës së zj. Elsa Toçi, për të ushtruar veprimtarinë e Aktuarit të Autorizuar.**
- 2. Autorizimi jepet me afat 3-vjeçar me të drejtë rinovimi.**
- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI**